



Republika e Kosovës * Republika Kosova * Republic of Kosova

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale
Nezavisna Komisija za Rudnike i Minerale
Independent Commission for Mines and Minerals



Prishtinë më: 25.03.2011

Në pajtim me nenin 24,34,41,59 dhe 62, të ligjit nr. 03/L-163, për Minierat dhe Mineralet, Bordi i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, me qëllim të rregullimit, sigurisë, avancimit të punës në industrinë minerare dhe raportimit sa më të saktë, në mbledhjen e mbajtur me 24.02.2011, nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

(KPMM NR. 001/2011)

PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR PERSONAT PËRGJEGJËS NË KOMPANITË TË CILAT JANË TË LICENCUAR NË KPMM

Neni 1 Qëllimi

1.1. Me anë të këtij udhëzimi rregullohet dhe përcaktohet mënyra e caktimit të personave përgjegjës në ushtrimin e veprimtarive në industrinë minerare. Duke pasur parasysh dinamikën e punëve në miniera, dhe punën shumë të ndjeshme në sektorin minerar me anë të këtij udhëzimi synohet të arrihet parandalimi i aksidenteve, menaxhimi i punëve në minierë, siguria më e madhe në realizimin e detyrave të përditshme të punës në objektet minerare.

1.2. Duke pasur parasysh të gjitha efektet minerare, KPMM fillon së zbatuari dispozitat e këtij udhëzimi si nevojë permanente për vendosjen e rregullave, rendit, sigurisë dhe raportimit në punë lidhur me aktivitetet minerare.

1.3. Si qëllim tjetër evident është edhe përgatitja e raporteve ku kërkohet raportimi nga çdo i licencuar sipas neneve 24, 34 dhe 41 të ligjit për Minierat dhe Mineralet.

Neni 2 Udhëheqja dhe mbikëqyrja teknike tek Licencat për Hulumtim

2.1. Çdo kompani e cila aplikon për hulumtim për çfarëdo lloji të mineralit mundet me paraqitje për person përgjegjës Inxhinier apo Bachelor të gjeologjisë dhe xehetarisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

Rr. Armend Daci Nr.1
Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (38) 240 252
Fax: +381 (38) 245 844
E-mail: ICMM@kosovo-mining.org
Web: www.kosovo-mining.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

2.2. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri apo Bachelori duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë pune në një kompani minerare.

2.3. Një person përgjegjës mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm në një (1) kompani minerare.

Neni 3

Udhëheqja dhe mbikëqyrja teknike tek licencat për shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit

3.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin e rërës dhe zhavorrit, aplikuesi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së punëve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje dhe siguri gjatë punës.

3.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i xehetarisë, gjeologjisë (mund të jetë edhe Bachelor), i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

3.3. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri (Bachelor) duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë pune në një kompani minerare.

3.4. Një person përgjegjës në kompani mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni më së shumti për dy (2) kompani minerare.

3.5. Dispozitat e këtij neni detyrimisht zbatohet edhe te rëra kuarcore.

Neni 4

Udhëheqja dhe mbikëqyrja teknike në gurore me kapacitet nën 100,000 m³

Shfrytëzim

4.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin e materialeve ndërtimore (gurore) me kapacitet më të vogël se 100 000 m³ në vit, aplikuesi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së punëve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje dhe siguri gjatë punës.

4.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i xehetarisë, gjeologjisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

4.3. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë pune në një kompani minerare.

4.4. Një person përgjegjës në kompani mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani minerare.

Neni 5

Udhëheqja dhe mbikëqyrja teknike në gurore me kapacitet mbi 100,000 m³

Shfrytëzim

5.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin materialeve ndërtimore (gurore) me kapacitet mbi 100 000 m³ në vit, aplikuesi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së punëve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje dhe siguri gjatë punës.

5.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i xehetarisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

5.3. Raportimin e rezervave për këtë kategori duhet të kryejë inxhinieri i gjeologjisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

5.4. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë pune në një kompani minerare.

5.5. Personat kompetent sipas paragrafëve 2, 3 të këtij neni mund të mbulojnë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani minerare.

Neni 6

Udhëheqja teknike në minierat metalike

6.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në shfrytëzimin e resurseve minerale metalike, energjetike, hidrokarbureve, mineraleve industriale, kryerësi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së aktiviteteve minerare sipas projekteve minerare, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje dhe siguri gjatë punës.

6.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri i xehetarisë, i cili ka kryer me sukses provimin profesional.

6.3. Raportimin e rezervave për këtë kategori duhet të kryejë inxhinieri i gjeologjisë, i cili ka kryer me sukses provimin profesional.

6.4. Personat kompetent sipas paragrafëve 2, 3 të këtij neni mund të mbulojnë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani minerare.

Neni 7
Udhëheqja e procesit teknologjik tek Lejet për Aktivitete të Veçanta (përpunimi i lëndëve të para minerare)

7.1. Gjatë kryerjes së aktiviteteve minerare në proceset teknologjike të përpunimit të lëndëve të para minerale (Flotacionet – nyjet e përpunimit të xehes), kryerësi është i obliguar të siguron udhëheqje dhe mbikëqyrje teknike të kryerjes së aktiviteteve sipas projekteve përkatëse, dispozitave teknike, si dhe sipas dispozitave për mbrojtje dhe siguri gjatë punës.

7.2. Për person kompetent – mbikëqyrje teknike në kuptim të paragrafit 1 të këtij neni mund të emërohet inxhinieri apo Bachelor i: Xehetarisë, Teknologjisë, Gjeologjisë, Metalurgjisë dhe Makinerisë, i cili ka kryer me sukses stazhin e praktikantit.

7.3 Për person kompetent – mbikëqyrje teknike për aktivitet e veçanta Flotacionet – nyjet e përpunimit të xehes duhet të ketë të kryer edhe provimin profesional (tek këto aktivitete nuk mund të jetë inxhinier i makinerisë).

7.4. Për kryerjen e stazhit të praktikantit inxhinieri apo Bachelor duhet të posedoj diplomë universitare të drejtimeve përkatëse dhe së paku gjashtë (6) muaj përvojë pune në një kompani minerare.

7.5. Një person përgjegjës i kompanive mund të mbulojë në të njëjtën kohë detyrimet që dalin nga paragrafi 1 i këtij neni vetëm për një (1) kompani.

Neni 8
Shqyrtimi i kërkesave

8.1. Me rastin e paraqitjes së çdo aplikacioni në KPMM, aplikuesi duhet të paraqet personin përgjegjës i cili nuk bie ndesh me dispozitat e këtij udhëzimi.

8.2. Zyra kompetente për pranimin e aplikacionit në KPMM duhet të përkujdeset se me rastin e paraqitjes së kërkesës, personi përgjegjës i propozuar nga parashtruesi i kërkesës nuk është duke zhvilluar veprimtarin te ndonjë kompani e cila do të bie në kundërshtim me dispozitat e këtij udhëzimi. Në rast se një person është duke zhvilluar aktivitet te ndonjë kompani atëherë çdo kërkesë e cila bie në kundërshtim me këtë udhëzim nuk pranohet.

8.3. Çdo parashtrues i kërkesës duhet që të merr aplikacionin për personin përgjegjës të përcaktuar nga KPMM dhe të plotësoi në mënyrën e përcaktuar në formular si dhe të sjell edhe një CV (autobiografi e shkurtër), një kopje të diplomës së vërtetuar nga organi kompetent mbi shkollimin e kryer.

8.4. Të gjitha kompanitë të cilat posedojnë licenca aktive nga KPMM janë të obliguar të caktojnë personin përgjegjës sipas këtij udhëzimit brenda afatit prej 30 ditëve.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Me këtë udhëzim Administrativ shfuqizohen nenet 14, 15, 16, 17, 18 të udhëzimit Administrativ 001/2009.

Ky udhëzim Administrativ hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare.


Ahmet Tmava
Kryesues i Bordit
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale

